



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 16 (827820)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 prill 2023

Prezantohet komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia

Prezantohet në një ceremoni të veçantë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. I pranishëm në këtë ceremoni, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e dhënë në detyrat e mëparshme nga gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. "Gjeneral Xhebexhia vjen në krye të Forcës Tokësore pas një karriere të gjatë ushtarake, me detyra të shumta brenda

dhe jashtë vendit, me një eksperiencë të shkëlqyer në përfaqësim dhe drejtim. Ka përfaqësuar Forcat e Armatosura në NATO dhe në vendet partnere si dhe ka drejtuar me profesionalizëm Forcën Detare dhe Komandën Mbështetëse. Gjeneral Xhebexhia vjen në këtë detyrë pas arritjesh shumë domethënëse të kësaj strukture, përmend këtu, certifikimin me shumë sukses të Grup

Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë gjatë muajit shtator të vitit të kaluar, kryerjen e një sërë misionesh të rëndësishme në kuadër të Aleancës si dhe menaxhimin me sukses të shumë emergjencave civile: zjarret, përmbytjet apo emergjenca të tjera, me të cilat vendi ynë përballlet", - u shpreh në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes. Më tej, ministri Peleshi...



»» faqe 2

Ministri Peleshi pret znj. Stefania Craxi, Kryetare e Komisionit të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme të Senatit Italian



»» faqe 3

Gjeneral brigade Arben Kingji mban leksion si i ftuar nderi në KLO

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO), kishte mundësinë të dëgjonte si lektor nderi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji. Gjeneral brigade Kingji mbajti leksion me temë "Mjedisi i ri i sigurisë dhe zhvillimet në Forcat e Armatosura", duke u ndalur në situatën e fundit të sigurisë në rajon, prioritetet kryesore të zhvillimit të FA-së, arsimimi, kualifikimi, bashkëpunimi, angazhimet ndërkombëtare aktuale dhe në të ardhmen. Pjesëmarrësit...



»» Faqe 4

Merr detyrën komandanti i ri i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo është prezantuar sot në detyrën e re, atë të komandantit të Komandës Mbështetëse. Të pranishëm ishin, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji. Ministri Peleshi u shpreh se: "Gjeneral brigade Ferdinand Dimo vjen në krye të Komandës Mbështetëse pas një karriere të gjatë ushtarake, në detyra të të gjitha niveleve dhe ofron një...



»» Faqe 5

Nëse jam gabim, më edukoni, mos më poshtëroni!

Prindër ... Sa këshilla të ndryshme nga psikologët, edukatorët, dhe natyrisht, nga gjyshet mund të gjenden në faqet e revistave, gazetave, rrjeteve sociale. Ka këshilla të vlefshme. A janë gjithnjë efektive? Ndonjëherë duket se ato janë shkruar nga njerëz të cilët vetë nuk kanë fëmijë. Do të doja të tregoja disa shembuj të edukimit që prindërit e mi zbatuan në rritjen time dhe vëllait disa vite më të madh. Rregulli i parë. Asnjëherë nuk jam ndëshkuar fizikisht. Në familjen time, çdo sjellje e keqe ndahej mes pjesëtarëve të familjes. Mami dhe babi nuk bërtisinin...



»» Faqe 5

Prezantohet komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia

Prezantohet në një ceremoni të veçantë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. I pranishëm në këtë ceremoni, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi kontributin e dhënë në detyrat e mëparshme nga gjeneral brigade Ilir Xhebexhia.

“Gjeneral Xhebexhia vjen në krye të Forcës Tokësore pas një karriere të gjatë ushtarake, me detyra të shumta brenda dhe jashtë vendit, me një eksperiencë të shkëlqyer në përfaqësim dhe drejtim. Ka përfaqësuar Forcat e Armatosura në NATO dhe në vendet partnere si dhe ka drejtuar me profesionalizëm Forcën Detare dhe Komandën Mbështetëse. Gjeneral Xhebexhia vjen në këtë detyrë pas arritjesh shumë domethënëse të kësaj strukture, përmend këtu, certifikimin me shumë sukses të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë gjatë muajit shtator të vitit të kaluar, kryerjen e një sërë misionesh të rëndësishme në kuadër të Aleancës si dhe menaxhimin me sukses të shumë emergjencave civile: zjarret, përmbytjet apo emergjenca të tjera, me të cilat vendi ynë përballet”, - u shpreh në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes.

Më tej, ministri Peleshi theksoi mbështetjen që qeveria ka treguar dhe do të vijojë të japë. “Të gjithë jemi dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha që kanë shënuar Forcat e Armatosura prej vitit të kaluar. Falë mbështetjes së qeverisë Forcat e Armatosura tashmë shënojnë standarde të larta dhe tashmë



të krahasueshëm me ato të vendeve aleate. Trajtimi i personelit ka shënuar një rekord të pamenduar më parë përmes rritjes me 40% të pagave në të gjitha nivelet. Ju siguroj se mbështetja financiare për Forcat e Armatosura do të vazhdojë të jetë e shumanshme, jo vetëm në drejtim të pagave, por edhe të strehimit, transportit, kujdesit shëndetësor si pjesë e një pakete sociale, për të cilën po punojmë çdo ditë”, - theksoi ministri. Në ceremoninë e prezantimit të komandantit të Forcës Tokësore ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili e mbante këtë

detyrë më parë. Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia deri më tani ka shërbyer si komandant i Forcës Detare, si komandant në Komandën Mbështetëse, ndërsa më herët ka mbajtur detyra si: zëvendëskomandant në Qendrën e Radio - Zbulimit, shef Sektori i Operacioneve dhe Stërviçjes në Forcën Tokësore, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërviçjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Ai ka qenë edhe zëvendës përfaqësues ushtarak i RSH-së në NATO si dhe atashe ushtarak i RSH-së në Mbretërinë e Belgjikës, jo rezident në Republikën e Francës.

Garda Kombëtare e New Jersey-it dhe Akademia e Forcave të Armatosura, në stërviçjen verore “Dardanët 23”

Akademia e Forcave të Armatosura dhe Garda Kombëtare e New Jersey-it, kanë bashkuar forcat në stërviçjen verore “Dardanët 23”.

Studentët tanë, po demonstrojnë nivel të lartë përgatitjeje në trajnimet e mirë planifikuara nga stafi i instruktorëve amerikanë dhe pedagogëve të AFA-së.

Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe trajnimit ushtarak, përmes zhvillimit në praktikë të trajnimeve të përbashkëta me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, është një ndër hapat e



para të shndërrimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, në një sistem akademik ushtarak të ndërveprueshëm brenda NATO-s.

Krenarë që jemi pjesë e kësaj nisme që promovon bashkëpunimin me SHBA-në dhe unitetin drejt një qëllimi të përbashkët





Ministri Peleshi pret znj. Stefania Craxi, Kryetare e Komisionit të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme të Senatit Italian

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në takim znj. Stefania Craxi, Kryetare e Komisionit të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme të Senatit Italian.

Mes dy palëve u diskutua për lidhjet e forta mes Shqipërisë dhe Italisë dhe sfidat me të cilat përballet rajoni.

Nga ana e tij ministri Peleshi rikonfirmoi përkushtimin e vendit tonë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Gjithashtu ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen e Italisë në rrugën e Shqipërisë drejt integritetit euroatlantik, duke marrë garancinë e znj. Craxi se Italia do të vazhdojë të mbështesë pa u lodhur Shqipërinë, dhe do të punojë për sigurinë në Ballkanin Perëndimor.



Kursi i Lartë i Oficerit zhvillon vizitë mësimore në Republikën e Kosovës

Në kuadër të programit akademik, stafi dhe kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit zhvilluan një vizitë mësimore treditore në Republikën e Kosovës. Gjatë ditës së parë ata u pritën nga Ministri i Mbrojtjes z. Armend Mehaj, i cili iu uroi mirëseardhjen dhe më tej ai iu foli mbi rëndësinë e bashkëpunimit për çështje të sigurisë në funksion të interesave të përbashkëta, gjithmonë në dobi të sigurisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Ai citoi se "Lidhjet e ngushta vëllazërore na obligojnë që t'i qëndrojmë pranë njëri-tjetrit, andaj pashkëputshëm, çdoherë e më shumë do të forcohet ky bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përmes shkëmbimit të përvojave ushtarake në shkollim, trajnime dhe stërvitje të nivelit taktik, operacional dhe strategjik. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë me njësinë homologe të saj në Kosovë, si dy institucione arsimore do të vazhdojnë ofrimin e ndërsjellë të shkollimit të kuadrove ushtarakë për drejtim dhe planifikimin sipas niveleve.

Gjatë pjesës së dytë të vizitës,



stafi pedagogjik dhe pjesëmarrësit e kursit vizituan Shtabin e Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ku u pritën nga Shefi i stafit të SHP-së, general brigade Ilir Qeriqi dhe pjesëtarë të tjerë të stafit. Pjesëmarrësit më anë

të prezantimeve u njohën me: arrijtet e FSK-së, sfidat dhe objektivat për të ardhmen, bashkëpunimin me partnerët e në mënyrë të veçantë me Republikën e Shqipërisë për kontributin dhe ndihmën që ka dhënë dhe po jep në ndihmë



të FSK-së, në ngritjen profesionale të oficerëve dhe nënoficerëve të saj.

Vizita e kursantëve të Kursit të Lartë të Oficerit në Republikën e Kosovës bëri të mundur njohjen nga afër të misionit, strukturës dhe rolit

aktual të institucioneve të mbrojtjes që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë, si dhe të vlerave kulturore dhe historike të vendit, duke përbushur në këtë mënyrë objektivat e programit akademik të kursit.

Gjeneral brigade Arben Kingji mban leksion si i ftuar nderi në KLO

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO), kishte mundësinë të dëgjonte si lektor nderi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji. Gjeneral brigade Kingji mbajti leksion me temë “Mjedisi i ri i sigurisë dhe zhvillimet në Forcat e Armatosura”, duke u ndalur në situatën e fundit të sigurisë në rajon, prioritetet kryesore të zhvillimit të FA-së, arsimimi, kualifikimi, bashkëpunimi, angazhimet ndërkombëtare aktuale dhe në të ardhmen.

Pjesëmarrësit e grupit mësimor treguan interes mbi temën e prezantuar dhe adresuan pyetje mbi çështje të caktuara. Zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi, në emër të stafit akademik dhe kursit falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, për kohën e kushtuar dhe prezantimin mbi situatën e sigurisë në rajon dhe zhvillimet në Forcat e Armatosura.



Zhvillohet Konferenca Fillestare Planëzuese (IPC/MPC) për stërvitjen e përvitshme të Forcës Detare “Imponimi 23”

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare u zhvillua Konferenca Fillestare/Kryesore Planëzuese (IPC/MPC) për stërvitjen e përvitshme të Forcës Detare “Imponimi 23”, e cila këtë vit për herë të parë do të zhvillohet e integruar me stërvitjen “Sarex 23”, në Durrës.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, gjatë zhvillimit të konferencës i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, duke i falënderuar gjithashtu për angazhimin e institucioneve që ata përfaqësonin.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga Prefektura Durrës, Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Ajrore, QKKSH, QNOD, Policia Kufitare dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Porteve, Autoriteti Portual Durrës, Kapitaneria e Portit dhe Antikontrabanda Detare. Pas fjalës përshëndetëse, pjesëmarrësit në konferencë ndoqën brifingun e përgatitur për mënyrën e zhvillimit të stërvitjes, bazën ligjore, periudhën, si dhe skenarët e stërvitjes së koduar “Imponimi/Sarex 23”.

Gjatë konferencës pjesëmarrësit paraqitën interes, si dhe dhanë mendime dhe sugjerime në mënyrë që stërvitja të zhvillohet me skenarë sa më realë. Konferenca tjetër planëzuese do të mbahet në muajin maj 2023, gjatë së cilës do të diskutohet për detajet dhe skenarët e stërvitjes në vijim.



Efektivë të Forcës Detare dhurojnë gjak

Personeli i Forcës Detare në Qendrën Shëndetësore të Flotiljes Pashaliman, iu bashkua nismës që po zhvillohet për seancat e dhurimit vullnetar të gjakut për fëmijët talasemik me moton: “Shpenzo 10 minuta nga koha jote për të shpëtuar 3 jetë!”.

Dhurimi i gjakut u realizua në prezencën dhe kujdesin e personelit shëndetësor të qendrës shëndetësore të Forcës Detare, si dhe të personelit shëndetësor nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.



Merr detyrën komandanti i ri i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo është prezantuar sot në detyrën e re, atë të komandantit të Komandës Mbështetëse.

Të pranishëm ishin, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji.

Ministri Peleshi u shpreh se: “Gjeneral brigade Ferdinand Dimo vjen në krye të Komandës Mbështetëse pas një karriere të gjatë ushtarake, në detyra të të gjitha niveleve dhe ofron një shembull të shkëlqyer të ushtarakut serioz, bashkëpunues dhe të respektuar”.

Sipas ministrit Peleshi, falë rezultateve të arritura nën drejtimin e gjeneral brigade Xhebexhisë, komandanti i ri i Komandës Mbështetëse do ta ketë më të lehtë që të vijojë të çojë përpara këtë strukturë vitale dhe tepër të rëndësishme për Forcat e Armatosura.

Teksa evidentoi arritjet e Forcave të Armatosura, veçanërisht gjatë vitit të fundit, ministri i Mbrojtjes siguroi se, mbështetja financiare e Qeverisë do të vijojë të jetë e shumanshme, jo vetëm në drejtim të pagave, por edhe të strehimit, transportit dhe të kujdesit shëndetësor: “Forcat e Armatosura vijnë të transformohen dhe modernizohen dita ditës me armatim, teknikë dhe pajisje nga më modernet. Projektet ambicioze



të modernizimit me teknikë, aparatura dhe pajisje të Komandës Mbështetëse, jo vetëm që do të mundësojnë arritjen e një stadi më të lartë të gatishmërisë dhe operacionalitetit, por edhe do të ofrojnë një mbështetje më të plotë e më të gjithanshme për të gjitha strukturat e tjera të Forcave të Armatosura”, - theksoi ministri Peleshi.

Ceremonia e prezantimit të gjeneral brigade Ferdinand Dimo, në detyrën e komandantit të Komandës Mbështetëse zhvillohet një ditë pas prezantimit në detyrën e komandantit të Forcës Tokësore të gjeneral brigade Ilir Xhebexhia.

Në Ambientet e Policisë Ushtarake përfundoi kursi funksional “Policia Ushtarak”

Kursi u zhvillua për herë të parë, ku u bë i mundur sigurimi i gjithë infrastrukturës për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor.

Kursi funksional synoi në përmirësimin dhe rifreskimin e njohurive të plota në rregullore bazë, ligjshmëri e PU-së, përgatitje fizike, Mnzsh, qarkullim rrugor, Rend ushtarak, Operacionet e PU-së, Përgatitje speciale.

Programi mësimor për kursin funksional u zhvillua

në përputhje të plotë me misionin që ka ky kurs.

Materialet mësimore të nevojshme si leksione, brifingje, si dhe përgatitja për çdo temë për programin mësimor u ndërthurën ngushtë teorikisht dhe praktikisht.

Sfida për stafin mësimdhënës ka qenë dhe do vazhdojë të jetë vlerësim real sipas aftësive që jep çdo kursant, sfidë kjo që padyshim do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e nivelit profesional që do të trajnohen në vazhdimësi në Seksionin e Stërvitjes në Policinë Ushtarake.



EOD, siguri, përkushtim, angazhim ndaj komunitetit

Siguria në komunitet është arsyeja pse ekipi i specialistëve të EOD, prej një muaji është duke inspektuar me përpikëri ish-vendet e depozitimit të municioneve në të gjithë vendin, për t'u siguruar që ato janë të hermetizuara, e larg aksesit të padëshirueshëm.

Vlerësim maksimal për përkushtimin dhe angazhimin e tyre për të mbajtur komunitetet tona të mbrojtura.

Siguria nuk është vetëm një prioritet, është një përgjegjësi që Forcat e Armatosura e mbajnë mbi supet e tyre, duke ofruar garanci të plotë.



Nëse jam gabim, më edukoni, mos më poshtëroni!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Prindër ...

Sa këshilla të ndryshme nga psikologët, edukatorët, dhe, natyrisht, nga gjyshet mund të gjenden në faqet e revistave, gazetave, rrjetëve sociale. Ka këshilla të vlefshme. A janë gjithnjë efektive? Ndonjëherë duket se ato janë shkruar nga njerëz të cilët vetë nuk kanë fëmijë. Do të doja të tregoja disa shembuj të edukimit që prindërit e mi zbatuan në rritjen time dhe vëllait disa vite më të madh.

Rregulli i parë

Asnjëherë nuk jam ndëshkuar fizikisht. Në familjen time, çdo sjellje e keqe ndahej mes pjesëtarëve të familjes.

Mami dhe babi nuk bërtisnin, nuk tundin duart. Në vend të kësaj, ne uleshim në shtrat në dhomën e gjumit dhe ata na shpjegonin se ku kishim gabuar, duke dhënë argumente dhe shembuj nga jeta e tyre.

Unë jam shumë mirënjohëse për ta, për këtë mënyrë komunikimi.

Është e papranueshme nëse do të ndëshkohesha fizikisht. Por në familjet e tjera kjo nuk është e pazakontë. Dhe ndonjëherë prindërit e shpjegojnë këtë me faktin se fëmija i tyre i dashur nuk i kupton fjalët. Unë besoj që të flasësh me një fëmijë për veprimet e tij duhet të jetë që nga fëmijëria e hershme, duke mos justifikuar faktin se ai është i vogël dhe nuk kupton asgjë. Fëmijët mendojnë se prindërit e tyre janë të mërzitur ndonjëherë, ata me të vërtetë nuk e kuptojnë.

Rregulli i dytë

Ata kurrë nuk na detyruan të bëjmë asgjë që nuk na përmbushte shpirtërisht..., fëmija, dhe veçanërisht në adoleshencë, nuk e pranon tonin e komandës.

Rregulli i tretë

Ju duhet t'i besoni fëmijës tuaj, mos e privoni atë nga pavarësia. Familja ime më besoi që nga fëmijëria e hershme. Në fillim, natyrisht, ata kontrolluan nëse bëra gjënë e duhur. Menduan se nuk e vura re! Unë pashë gjithçka në mënyrë të përsosur, por nuk u ofendova, pasi ata nuk më bënë asnjë koment. Nëna ime thoshte që, ata të mësojnë nga gabimet, tregoju te tuat: Bleva diçka të gabuar, kam humbur para, kam tradhtuar një mik. Pjesa nga jeta e tyre e përditshme për të kuptuar të tashmen tonë.

Tani jam e rritur, nënë e një djali adoleshent. Dhe përballja ime me të duket e lehtë, sepse unë kam mësuar të rritem me praninë e lirisë me norma dhe rregulla.

Prindërit nuk u besojnë shumë miqve të fëmijëve të tyre, kanë frikë se fëmijët do të bëjnë një gabim, vazhdimisht i kontrollojnë ata, ata bëjnë dhe vendosin shumë për ta. Prandaj, djemtë dhe fillojnë të bëjnë



gjëra në kundërshtim me prindërit e tyre. Dhe jo sepse ata vërtet e dëshirojnë këtë, ata thjesht duan të dëshmojnë se tashmë kanë të drejtë të vendosin vetë se çfarë të bëjnë.

Rregulli i katërt

Unë jam më i miri për prindërit e mi! Kurrë, as nëna dhe as babai nuk e lejuan veten e tyre në publik të më kritikojnë. Nëse do të ishte e nevojshme, ajo bëhej vetëm në shtëpi dhe pa të huaj. Më duket se ata prindër që e bëjnë këtë janë të gabuar. Për të huajt, kjo nuk është interesante dhe shkakton thashetheme. Gjëja më e keqe që prindërit mund të bëjnë akoma, kur fillojnë të krahasohen jo në favor të fëmijës, tallen, lexojnë shënime.

Rregulli i pestë

Prindërit e mi ishin të interesuar për jetën time, interesat e mia, të njohurit, hobia. Jo ndërhyrës, ata thjesht pyesnin, jepnin këshilla, qeshnin së bashku, mërziteshim së bashku. Dhe nëse e konsideronin veten fajtor për diçka, ata nuk ndruheshin ta pranonin atë dhe të kërkonin falje. Kjo është një marrëdhënie e barabartë.

Gjëja më e rëndësishme në familjen time është dashuria! Pa të, të gjitha rregullat do të ishin të pakuptimta!

Që një fëmijë të rritet për të qenë një person i mirë, ka nevojë për prindër të dashur dhe një familje në të cilën mbretëron dashuria.

Dashuria dhe mirëkuptimi i ndërsjellë në familje është ndezja më e mirë për vatrën familjare.

Në mënyrë që fëmija të bëhet miku dhe ndihmësi ynë, kushtojini më shumë vëmendje atij, shpenzoni më pak kohë në punë, përndryshe 'kostoja' do jetë shumë e madhe.

Harrojeni, në prani të fëmijës tuaj, të gjitha problemet që ndodhën gjatë ditës. Mos e ndëshkoni dhe mos e shani. Jini më të sjellshëm. Puthe dhe përqafoje kur shkon në shkollë dhe takoje gjithmonë me buzëqeshje, pavarësisht streseve

të ditës.

Ju duhet të shkoni në udhëtime, të luani së bashku me ta, atëherë ju jeni një ekip dhe mund të jeni të lumtur të gjithë së bashku.

Prindërit duhet të dinë që fëmijët janë ndihmësit e tyre. Por edhe fëmijët kanë nevojë për ndihmë. Dhe më e rëndësishmja, ju keni nevojë që fëmija të ndiejë se e duan atë,

'Më duaj si jam, të dua për atë që je', sepse ne nuk zgjedhim njëri-tjetrin. Mos prisni nga ata se do të jenë si ju, por përkundrazi ndihmohjini të bëhen vetvetja, sepse secili person është individual. Mos e shaj dhe mos e poshtëro, por ndihmoje të bëhet më i mirë.

'Mos më thuaj që jam ende i vogël dhe nuk mundem! Nëse rritem, gjithçka do të jetë e mundur për mua?' Mos harroni se me të vërtetë më pëlqen të eksperimentoj dhe mos më qortoni për të. Si rezultat i kësaj, pavarësia ime është rritur.

Prindër...

Ne vijmë nga nivele kulture dhe arsimore të ndryshme nga njëri-tjetri dhe kuptohet që tek fëmijët tanë delegojmë atë pjesë të formimit që 'gëzojmë' vetë, një gjë na lidh të gjithëve në një emërues të përbashkët, dashuria prindërore, të cilën realisht duhet të dimë ta japim me po kaq kujdes.

Familja si institucion i rëndësishëm dhe kontributor në formimin e fëmijës, duhet të tregojë më shumë se kujdes në ecurinë e formimit të tij, për ta bërë të kuptojë rëndësinë e jetës së vlerë dhe dinjitetit personal.

Pse është e rëndësishme të kesh një ndjenjë dinjiteti?

Këtu janë arsyt kryesore pse është e rëndësishme të keni vetëbesim:

Një person plot besim në vetvete ngjall ndjenja të ngjashme të tjerët. Ai është i besueshëm, di të lundrojë në çdo situatë, ju dëshironi ta dëgjoni, dëshironi ta ndiqni. Ai është i respektuar

nga të tjerët dhe nuk lejon sjellje të padenjshme ndaj tij.

Nëse ndjenja e vetëvlerësimit ulet, lind një kompleks, "viktimizimi". Një person i pasigurt dhe i ndrojtur e kupton veten të mjerë dhe të pavlerë. E njëjta gjë vlen edhe për ata që e rrethojnë. Zhvillimi dhe arritja në një situatë të tillë është e vështirë.

Dhe e gjitha kjo për shkak të frustrimit nga fëmijëria e deri më sot.

Ai që nuk e do veten dhe ndihet i padenjshëm, përndiqet nga dështimi. Sa herë që bindet për dështimin e tij, nuk i vëren sukseset e tij. Ai thjesht nuk i sheh ato.

I gjithë fokusi i vëmendjes përqendrohet vetëm te problemet. Një person i tillë nuk është i vetëdijshëm për të drejtat e tij. Një person që nuk është i sigurt për vlerën e tij është i kapërcyer nga një ndjenjë dëshpërimi, ai përkulet nën peshën e problemeve. Gjendja në depresion mund të çojë në çrregullime nga ana e sistemit nervor, manifestime psikosomatike dhe depresion.

Për mungesën e vetëvlerësimit, ju paguani me mungesë dashurie dhe respekti nga të tjerët.

A nuk është çmimi shumë i lartë?

A është e mundur të ndryshohet situata?

Askush nuk ka lindur tashmë me një ndjenjë dinjiteti. Vetëvlerësimi, vetë-respekti që një person merr nëpërmjet edukimit. Nëse që nga fëmijëria e hershme ka marrë shumë dashuri dhe vëmendje, është ndjerë i nevojshëm dhe i vlefshëm, ai do të mbetet i tillë gjatë gjithë jetës së tij. Nëse jo, atëherë shanset janë të larta për vetëbesim të ulët, duke çuar në mungesë të vetëvlerësimit.

Kultivimi i ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës në vetvete është i arritshëm.

Të besosh se një person është i mirë siç është, të pranosh veten me të gjitha dobësitë dhe të metat e saj.

Të gjithë meritojnë më të mirën nga e drejta e lindjes.



Asim Peregja, oficeri që la gjurmë në drejtimin e Qendrës Kulturore të Ushtrisë

IN MEMORIAM

Asim Peregja ka lindur më 22 korrik 1944. Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” e kreu në vitet 1958-1962, ku doli me rezultate shumë të mira në mësim. Më tej ndoqi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, përkatësisht në vitet 1962-1964. Pas përfundimit të shkollës emërohet instruktor stërvitjeje në Brigadën e Parë të Këmbësorisë (Br.1K) në Tiranë. Për punë të mirë dhe rezultate në stërvitje zgjidhet në vitin 1966 sekretar i Komitetit të Rinisë së brigadës, detyrë që e kreu me mjaft pasion për katër vite rresht. Ndërsa në vitin 1970 nis studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike, në Degën e Filozofisë, të cilin e përfundoi me rezultate të larta dhe, në vitin shkollor 1974-1975, emërohet mësues në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”. Pas një viti pune dhe përpjekje, ku u dallua për punë kulturore dhe veprimtari me organizatën e rinisë, emërohet në drejtorinë e Kulturës në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këtë detyrë gjeti dhe njerëz të mirë që e ndihmonin dhe e përkrahnin pa rezerva kuadrin e ri. Midis tyre ishin Mitat Duka, që siç shprehet Asimi, “më ndihmonte dhe më përkrahte në çdo gjë, por edhe unë e dëgjoja dhe respektoja shumë”.

Për kulturë dhe rezultate të mira në sektorin e Kulturës që drejtonte, në vitin 1977 do të emërohej drejtor i Qendrës Kulturore të Ushtrisë.

SHQUP-i ishte një institucion mjaft i madh dhe kishte në varësi: Ansamblin e Ushtrisë, Estradën e Ushtarit,



Orkestrën Frymore dhe organizimin e aktiviteteve metodike në garnizonin e Tiranës, si dhe ndihmën metodike në shkallë ushtrie. Ky institucion kishte mbi 300 punonjës, artistë të ndarë në asamble, estradë, orkestër etj., ku në sektorin e korit me 60 këngëtarë, në kompleksin vokal me 16 veta, në

grupin e valleve me 12 çifte, orkestra me 33 orkestrantë, solistë 6 vetë dhe sektori ndihmues me 8 vetë, ku hynin rrobaqepës, këpucar, marangoz, etj.

Vetëm Ansambli i Ushtrisë kishte 147 artistë dhe punonjës. Orkestra frymore kishte gjithsej 83 veta nga këto 80 orkestrantë, një dirigjent, një komisar trupe dhe një magazinier. Estrada e Ushtarit kishte si organikë sektorin e aktorëve me 8 aktorë, sektorin e orkestrës me 7 orkestrantë dhe një dirigjent, 4 solistë dhe një shef trupe. Gjithsej, trupa e estradës kishte 21 vetë. Kjo ishte organika e trupës, por kishte fonde për të marrë muzikantë, aktorë dhe këngëtarë sa të shihej e arsyeshme. Të tri trupat artistike kishin mbi 250 artistë, punonjës të sektorit artistik, si dhe ndihmës.

Ndërsa vetë SHQUP-i në qendër përbëhej nga këta sektorë: sektori metodik me 4 specialistë që mbulonin punën kulturore, edukimin patriotik, kulturën masive dhe punën me librin. Të gjithë ishin ushtarakë, me arsim të lartë dhe specialistë të fushave përkatëse. Po në drejtori ishte dhe sektori i filmit me 3 operatorë, skenarist dhe regjisor, bibliotekën me 2 punonjës, një zdrukthëtar që plotësonte kërkesat e të gjithë trupave me nevojat për skenografi dhe materiale të ndryshme, kishte drejtor, nëndrejtor, sekretare të drejtorit, shef prapavije, llogaritare, shef llogarie, arkëtare, shef kuadri dhe institucioni pasojë me pastrues, bahçevan, magazinier, rekuizier, gjithsej 25 punonjës. Institucioni i SHQUP-it kishte organikisht 176 artistë dhe punonjës. Në përbërje të

tij llogarisim dhe shumë ushtarë që merrnim çdo vit si balerin, solistë, akrobatë, humoristë, pra çdo artist që spikaste në zhanre të ndryshme dhe vinte për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

Aktivitet dhe veprimtari të ngjeshur artistike gjatë vitit.

...Ansambli i ushtrisë, trupa e estradës dhe orkestra, pasi mbaronte një premierë, niseshin në turne në njësi dhe reparte të ushtrisë. Në të gjithë vendin jepeshin shfaqje si për qytetin ku shkonin, ashtu dhe për ushtarët në çdo pikë hapje, gjë e cila ishte detyra kryesore e tyre. Trupat kur shkonin nëpër reparte kishin raste që jepnin 2-3 shfaqje në ditë. Kështu vepronte dhe trupa e estradës së ushtarit dhe orkestra frymore. Pas një ndërprerjeje, Asim Peregja emërohet përsëri drejtor në këtë institucion në vitin 1997, për ta dorëzuar detyrën në vitin 2001. Në punë me qendrat kulturore të ushtrisë në këto vite, u kthyem në promotor të mjaft veprimtarive të dendura kulturore e artistike, ku gjetën mishërim të plotë pat’ hosi atdhetar, e vërteta shkencore, drejtësia historike.

Asim Peregja si oficer ishte një kuadër i përgatitur me aftësi organizuese dhe drejtuese, me aftësi, njohuri e përgatitje jo vetëm ushtarake, por edhe pedagogjike e metodike, të cilat i ushtroi në mësimdhënie, jo vetëm në ushtri, por edhe në lëndët shoqërore dhe filozofi në Universitetin e Tiranës për disa vite. Asim Peregja është vlerësuar me dekorata, medalje e urdhra për kontributin e tij gjatë shërbimit ushtarak në ushtri.

PROF. DR. QAMIL XHIKA, skënderbegasi, shkencëtar i bujqësisë, historian dhe mjek i njohur popullor

Një ndër nxënësit që kanë studiuar në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” dhe ka shkëlqyer në fusha të tjera, është dhe Prof. Dr. Qamil Xhika. Ai u bë agronom, shkencëtar i kulturës së misrit, historian, rapsod i folklorist dhe mjek i njohur popullor.

Qamil Xhika lindi më 1941 në Macukull të Matit. Arsimin bazë e kreu në vendlindje dhe pastaj kreu shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë në vitet 1955-1959. Për shkak të biografisë së tij politike që nuk ishte “e mirë” për regjimin e kohës, pa dëshirën e tij, dërgohet në ish-Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës (sot UBK) në degën agronomi, të cilin e mbaroi me rezultate shumë të mira. Tema e diplomës së agronomit të ardhshëm Qamil Xhika ishte: “Studimi krahasues i hibrideve më të përshtatshme për zonën e Burrelit, me qëllim rajonizimin”, me të cilën u titullua “Agronom i lartë” në vitin 1963. Që në ditën e parë si agronom në rrethin e Matit ai u mor me veprimtari të mirëfilltë shkencore dhe sidomos i kushtoi vëmendje të veçantë seleksionimit të gjenetikës dhe teknologjisë në shërbim të rajonizimit të kulturës së misrit, duke punuar në bashkëpunim të plotë me Universitetin Bujqësor të Kamzës. Ai bëri studime për misrin dhe evidentoi 21 popullata bazë të misrit, prej të cilave 14 me pjekje të hershme, 6 të mesme dhe 1 me pjekje të vonë. Nën drejtimin e tij u grumbulluan 173 emërtime autoktone farash (1972).

Puna e tij shkencore kulmon me krijimin e hibridit të misrit “Mati” që u mboll në 10 mijë hektarë të zonës bregdetare dhe ky zbulim e ktheu rrethin e Matit në një qendër shkollë



të përhapjes së eksperiencës në shkallë vendi. Falë Qamil Xhikës, hibridi i misrit “Mati” u eksperimentua në Mat dhe në gjithë vendin por gjithashtu u eksperimentua edhe në Greqi në pikat eksperimentale “Valtos” e “Kredico” të Selanikut, ku u morën rendimente të larta. Ai merr titullin shkencor, “Doktor i Shkencave Bujqësore”, me temën: “Rajonizimi i kulturës së misrit në rrethin e Matit”.

Qamil Xhika ka qenë anëtar i Institutit të Misrit dhe Orizit në Shkodër, Anëtar i Shoqatës së Prodhimit të Farërave të Shqipërisë, Anëtar i Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Shqipërisë, Anëtar i Katedrës Gjenetike të Universitetit Bujqësor të Kamzës, Kryetar i Këshillit Shkencor të rrethit Mat, Kryetar i Shoqatës “Elena Gjika” të Shqipërisë, rapsod i këngës popullore, studiues në fushën e historisë së lashtë, Doktor i Shkencave Bujqësore, mjek popullor.

Merita të veçanta ka ai në fushën e artit e kulturës dhe ka marrë pjesë me grupin “Mati” në të gjitha festivalet folklorike kombëtare; është dekoruar disa herë për nivelin e lartë të interpretimit dhe ka kënduar këngë kushtuar Bardhok Bibës, Dylejman Çelës, Shaban Agës, Zek Jakinit, Molla Hasanit, Shkurte Skurës, Macukullit,

Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Gjok Doçit, Zonja Çurres, Ilia Qiqit, Rexhep Pashë Matit, luftës së Varoshit etj.

Në fushën e historisë është marrë kryesisht me studime të personaliteteve shqiptare që kanë kryer veprimtarinë e tyre jashtë vendit në kohë të ndryshme.

Po kështu, Qamil Xhika kreu shkollën e mesme mjekësore dhe në bazë të studimeve personale arriti të bëhej mjek popullor duke arritur deri në 2800 raste mjekimi dhe në këto raste bëri evidentimin e bimëve kurative mjekësore në Mat dhe jo vetëm. Për 30 vjet rresht ka qenë bashkëpunëtor i rëndësishëm i Institutit të Misrit e Orizit në Shkodër dhe anëtar i këshillit shkencor të tij. Shkencëtari Prof. Dr. Ahmet Osja ka theksuar vazhdimisht se Dr. Qamil Xhika ishte i gjithanshëm... Megjithëse me biografi të “papërshtatshme” dhe me mjaft pengesa që i nxorën, ai çau vetë në shkencë, kulturë, art, histori e mjekësi popullore, duke u bërë i njohur në vend e më gjerë. Profesori nga Mati, u nda para kohe nga jeta por ai mbeti gjallë me veprën e tij të gjithanshme. Nga viti 2001 është “Qytetar nderi” i bashkisë Burrelit, ndërsa një rrugë në qytetin e Burrelit mban emrin: “Rruga Qamil Xhika”.

Për Profesor Qamil Xhikën kanë shkruar shumë personalitete, ku ndër të tjerë përmendim:

Hamdi Hysuka me monografinë “Skënder Xhika, një jetë në shërbim të shkencës”; autorët A. Farrici, B. Gjoni, Sh. Ballabani, N. Çupi, Gj. Pjetri, Hysen Laçe, L. Çapaliku; me botimin “Dr. Qamil Xhika, shkencëtar e folklorist”; Bashkim Frangu e Petrit Frangu, “Mirënjohje për njerëzit që kanë ikur”, (monografi, fq. 186-188) etj.

NATO DO TË MBETET NJË ALEANCË BËRTHAMORE

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

NATO dhe Departamenti i Shtetit i SHBA-së organizuan së bashku Konferencën e 18-të Vjetore të NATO-s mbi Kontrollin e Armëve, Çarmatimin dhe Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë (WMD), më 17-20 prill 2023, në Uashington DC.

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg iu drejtua kësaj Konference, më 18 prill 2023, me një fjalim ku nënvizoi rëndësinë e vazhdueshme të kontrollit të armëve për sigurinë aleate.

Sekretari i Përgjithshëm paralajmëroi se “kjo është një periudhë thellësisht sfiduese për kontrollin e armëve dhe për sigurinë tonë në përgjithësi”, dhe vuri në dukje modelin e Rusisë të “injomit, shkeljes ose braktisjes së pjesës më të madhe të rrjetit të marrëveshjeve ndërkombëtare të kontrollit të armëve që e kanë mbajtur botën të sigurt”. Ai paralajmëroi gjithashtu se “Kina po rrit me shpejtësi arsenalin e saj bërthamor pa asnjë transparencë në lidhje me aftësitë e saj” dhe se sfidat e mëtejshme vijnë nga programet bërthamore dhe sistemet e shpërndarjes iraniane dhe koreano-veriore, si dhe teknologjitë e reja si Inteligenca Artificiale dhe sistemet autonome.

“Në afat të shkurtër, - tha Stoltenberg, - aleatët duhet të forcojnë regjimet ekzistuese globale të kontrollit të armëve, kryesisht Traktatin e Mospërhapjes Bërthamore dhe Konventat e Armëve Kimike dhe Biologjike”. Ai gjithashtu nënvizoi rëndësinë e angazhimit me vendet në jugun global. Sekretari i Përgjithshëm, për të ardhmen, bëri thirrje për një qasje të re për t'u marrë me përhapjen e shpejtë të teknologjive të reja, shkatërruese. “Ne jemi të vendosur të zhvillojmë një standard ari të përbashkët, universal për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të reja në mbrojtje”, - tha ai. “Në NATO, ne e kemi filluar këtë proces me Strategjinë tonë të Inteligjencës Artificiale dhe parimet e saj të përdorimit të përgjegjshëm”. Ai më tej nënvizoi rëndësinë e angazhimit me Pekinin, dhe tha se “NATO është një platformë unike, ku ne angazhohemi me Kinën dhe komunitetin më të gjerë ndërkombëtar për përfitimim tonë reciprok, dhe, që aleatët të konsultohen për kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen”.

E organizuar nga një vend i ndryshëm çdo vit, konferenca e NATO-s për Armët e Shkatërrimit në Masë 2023 u zhvillua për herë të parë këtë vit në Shtetet e Bashkuara, në Uashington DC, dhe mbledhi së bashku më shumë se 150 pjesëmarrës nga rreth 50 vende. Stoltenberg foli në një seancë hapëse së bashku me Zëvendës Sekretaren e Shtetit, Wendy Sherman dhe Bonnie Jenkins, Nënsekretaren e Shtetit për Kontrollin e Armëve dhe Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare.

Peizazhi global i sigurisë është shqetësues

Mbajtja e Konferencës të 18-të vjetore të NATO-s, për Kontrollin e Armëve, Çarmatimin dhe Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë në Uashington, ishte ngjarjeje e rëndësishme. Pasi siç tha shefi i NATO-s në fjalën e tij, kjo është një periudhë thellësisht sfiduese, për kontrollin e armëve dhe për sigurinë tonë në përgjithësi, sepse lufta e Rusisë kundër Ukrainës është pjesë e një modeli të gjatë të sjelljes agresive. “Rusia kërkon të minojë themelet e sistemit të bazuar në rregulla ndërkombëtare me injorimin, shkeljen ose braktisjen e pjesës më të madhe të rrjetit të marrëveshjeve ndërkombëtare të kontrollit të armëve që e kanë mbajtur botën të sigurt. Kremli ka zgjedhur të çmontojë kontrollin e armëve dhe të minojë stabilitetin strategjik, duke pezulluar pjesëmarrjen e saj në Traktatin e Ri START, mosrespektimin e Traktatit INF, rritjen e retorikës provokuese bërthamore dhe

Stoltenberg: Ne jemi në udhëkryq për kontrollin ndërkombëtar të armëve



kërcënon të vendosë armë bërthamore taktike në Bjellorus. Këto janë veprime të papërgjegjshme, projektuar për të penguar aleatët e NATO-s të mbështesin Ukrainën, - tha Stoltenberg. - Por ato nuk do të funksionojnë, sepse ndërkohë që i marrim seriozisht kërcënimet e Rusisë, ne nuk do të frikësohemi. Rusia është kërcënim i drejtpërdrejtë për sigurinë tonë. Por peizazhi më i gjerë global i sigurisë është gjithashtu shqetësues”.

Kongresi i Lushnjës krijoi Senatin, Parlamentin e parë shqiptar (më vonë Këshilli Kombëtar), si organ legjislativ, i cili përbëhej nga 37 anëtarë të zgjedhur nga vetë delegatët e Kongresit. Kongresi shprehu në formë të organizuar politike vullnetin e shqiptarëve për të marrë fatin e vendit në duart e veta.

Në këtë periudhë afirmohen për herë të parë parimet e parlamentarizmit: emërimi dhe shkarkimi i Qeverisë nga Senati, si dhe ushtrimi i kontrollit parlamentar ndaj saj. Megjithëse parlamenti i parë shqiptar e shtriu veprimtarinë e tij legjislativë në një periudhë të shkurtër kohe, ai arriti të miratonte disa ligje të rëndësishme.

Akti më i rëndësishëm ishte Statuti i Lushnjës që përbënte një ligj kushtetues. Veprimtaria legjislativë e Këshillit Kombëtar mori fund në dhjetor të vitit 1920, kur Këshilli u shpërnda për t'ua lënë vendin zgjedhjeve të para në Shqipëri (mars 1921).

Këshilli Kombëtar (21 prill 1921 – 30 shtator 1923), Statuti i Zgjeruar i Lushnjës

Nga zgjedhjet që u zhvilluan në mars të vitit 1921, vendi u përfaqësua me 78 deputetë. Që prej kësaj periudhe, parlamenti filloi të shfaqej rregullisht si një organ i dalë nga populli, me detyra të përcaktuara qartë në statutin e kohës. Zgjerimi që iu bë Statutit të Lushnjës, i cili në histori njihet si statuti i shtetit shqiptar i vitit 1922, e shndërroi këtë akt në një kushtetutë të mirëfilltë me fuqinë më të lartë në shtet dhe sanksionoi plotfuqinë parlamentare.

Organi më i rëndësishëm që ushtronte pushtetin legjislativ, i quajtur Këshill Kombëtar mori emrin Parlament. Si organ i vetëm legjislativ ai përbëhej nga një dhomë deputetësh të cilët zgjidheshin nga populli në bazë të zgjedhjeve të përgjithshme (votim i tërthortë). Në këtë të periudhë dalloheshin qartë dy grupime politike: Partia Popullore e kryesuar nga Fan Noli dhe Partia Përparimtare e kryesuar nga Hoxhë Kadriu. Në fushën legjislativë, veprimtaria e Këshillit Kombëtar u përqendrua në nxjerrjen e ligjit për organizimin gjyqësor, në plotësimin e rregullores ekzistuese me elemente të reja për transparencën e veprimtarisë parlamentare, betimin e deputetëve përpara Këshillit, etj. Në shtator të vitit 1923, Këshilli Kombëtar i mbylli punimet e tij në përfundim të legjislaturës 2-vjeçare për t'ua lënë vendin zgjedhjeve të reja për Kuvendin Kushtetues, të cilat u mbajtën në dhjetor të po këtij viti.

Kuvendi Kushtetues, 21 janar 1924 – 2 mars 1925

Kuvendi Kushtetues, i përbërë nga 100 deputetë, ushtroi veprimtarinë e tij në dy periudha (21 janar – 2 qershor 1924 dhe dhjetor 1924 – 2 mars 1925). Detyra kryesore e tij ishte hartimi



dhe miratimi i një kushtetute të shkruar (prej së cilës mori dhe emrin) ku të sanksionohej forma e qeverisjes. Objektivi nuk u arrit në periudhën e parë të veprimtarisë së tij për shkak të acarimit të situatës politike në vend me vrasjen e Avni Rustemit dhe atentatit që iu bë kryeministrit të asaj kohe Ahmet Zogu. Më 2 qershor të vitit 1924 Kuvendi mbylli punimet e periudhës së parë. Pas shpërbërjes së Qeverisë, Ahmet Zogu u largua nga Shqipëria, duke mbetur në ilegalitet deri në dhjetor të vitit 1924. Gjatë kësaj periudhe erdhi në pushtet Qeveria e Fan Nolit, e cila pati një jetë të shkurtër (qershor-dhjetor 1924). Me rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet, moment që shënoi në histori të ashtuquajturin triumf të legalitetit, rifilloi punimet Kuvendi Kushtetues. Ai arriti të përmbushte detyrën për të cilën ishte krijuar: miratimin e Statutit Themeltar të Shtetit dhe përcaktimin e formës së tij.

Periudha e Republikës Shqiptare, 1925 – 1928

Statuti afirmonte formën e qeverisjes, duke e përcaktuar Shqipërinë si 'Republikë Parlamentare e kryesuar prej një kryetari, sovraniteti i së cilës buronte prej popullit'. Me një vendim të posaçëm të Kuvendit Kushtetues, Ahmet Zogu u zgjodh në krye të shtetit. Parlamenti, për herë të parë dhe të fundit në historinë parlamentare të Shqipërisë, paraqitet i përbërë nga dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Deputetëve. Sistemi dydhomësh pati një jetë të shkurtër parlamentare dhe përbënte eksperiencën e vetme në historinë parlamentare të Shqipërisë. Dhoma e Deputetëve (Dhoma e Ulët) përbëhej nga 57 deputetë të zgjedhur nga populli ndërkohë që Senati (Dhoma e Lartë) përbëhej nga 18 senatorë, 2/3 e të cilëve zgjidheshin nga populli, ndërsa 1/3 nga Kryetari i Republikës. Statuti afirmonte një sistem dydhomësh perfekt, por që në raste të caktuara i jepte përparësi Senatit, duke e vënë Dhomën në pozita inferioriteti. Një organ tjetër i Parlamentit ishte ai i mbledhjes së dy dhomave në një seancë të përbashkët, të quajtur Asamble Legjislativë, që paraqitej në statut si organ më vete. Gjatë kësaj kohe parlamenti miratoi një sërë ligjesh me rëndësi ndër të cilat mund të përmenden: ligjin mbi bankën kombëtare, ligjin e pensioneve civile, etj. Ai u karakterizua nga mungesa e pluralizmit dhe për shkak të problemeve të mëdha të sistemit zgjedhor, ruajti një karakter përfaqësues fiktiv. Mungesa e partive politike karakterizoi të gjithë periudhën e sundimit të Ahmet Zogut si Kryetar Republike e më pas si Mbret i Shqiptarëve. Shpërndarja e Parlamentit të Republikës erdhi pas debateve për ndryshimin e formës së qeverisjes, duke i lënë vendin zgjedhjeve të reja për Asambllën Kushtetuese.

Periudha e Mbretërisë Shqiptare, 1928 – 1939

Asambleja Kushtetuese, e dalë nga zgjedhjet e 17 gushtit 1928 me 58 deputetë, sanksionoi në statut formën monarkike të qeverisjes, dhe parashikoi sistemin njëdhomësh parlamentar.

Shqipëria shpallej mbretëri demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme, ndërkohë që Mbret i shqiptarëve sanksionohej Lartmadhëria e tij Zogu I, nga familja e famshme shqiptare Zogu. Ajo i dha fund punimeve, më 1 dhjetor 1928, duke u transformuar në parlament. Në këtë periudhë u miratuan akte të rëndësishme si kodi civil, kodi tregtar, kodi penal, apo kodi i procedurës civile

të cilët shënuan shkëputjen drastike nga legjislativi i periudhës osmane. Për këtë arsye, parlamenti i kësaj kohe u quajt nga Zogu I si parlament konstruktiv e parlament reformator. Pas pushtimit Italian të Shqipërisë, në prill të vitit 1937, Mbreti Ahmet Zogu I u largua nga Shqipëria. Mbretit të Italisë, Viktor Emanuelit III, iu ofrua kurora e Shqipërisë.

Parlamenti në periudhën e luftës

Sipas statutit themeltar të Mbretërisë shqiptare të akorduar nga mbreti Viktor Emanueli III, shteti shqiptar ishte Monarki Kushtetuese. Pushteti legjislativ ushtrohej nga mbreti në bashkëpunim me Këshillin e Epërm Fashist Korporativ. Më vonë, më 16 tetor 1943, me ardhjen e pushtesve nazistë u mbledh Kuvendi Kombëtar me 247 anëtarë, i cili rivendosi krijimin e Këshillit të Lartë si kryetar shteti. Ai u kthye në parlament, duke ushtruar pushtetin legjislativ së bashku me këtë organ. Kjo periudhë karakterizohet nga mohimi i parimeve të parlamentarizmit.

Parlamenti në periudhën e pasluftës

Zgjedhjet për Asambllën Kushtetuese të pasluftës u zhvilluan më 2 dhjetor 1945. Për herë të parë në votim morën pjesë edhe gratë. Në këtë periudhë u miratua kushtetuta e 14 marsit 1946, ku Asambleja Kushtetuese u kthye në Kuvend Popullor. Në kushtet e mungesës së pluralizmit politik në vend, Kuvendi Popullor ishte një organ formal, i cili mbledhej në sesione vetëm dy herë në vit. Në vitin 1976 Kuvendi Popullor miratoi Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila ruajti më tepër tiparet e një programi politik plotësisht të ideologjizuar me ideologjinë e kohës. Roli i parlamentit mbetej fiktiv, sa kohë që nuk sanksionoheshin zgjedhje të lira dhe as që mund të flitej për pluralizëm.

Rilindja e parlamentarizmit (1991)

Pas 5 dekadash në Shqipëri shfaqen shenjat e para të rilindjes së parlamentarizmit. Pas një periudhe 67-vjeçare mbledhet Parlamenti i parë pluralist i dalë nga zgjedhjet e 31 marsit 1991 (250 deputetë). Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese, i miratuar në këtë vit, solli ndryshime në kuadrin e organizimit demokratik të shtetit. Ai u plotësua gradualisht nga një sërë ligjesh të tjera kushtetuese, deri në miratimin e një kushtetute të re tërësore. Më 21 tetor 1998 Kuvendi Popullor miratoi Kushtetutën e re, të hartuar edhe me ndihmën e organizmave ndërkombëtarë. Kushtetuta e re krijoi mundësinë për të kuptuar më mirë sistemin politik në Shqipëri dhe rolin e aktorëve të tij. Emërtimi "Kuvend Popullor" ndryshohet në "Kuvend i Shqipërisë" (njëdhomësh, 140 deputetë). Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Kuvendi, si organi më i lartë i Pushtetit ligjvënës, vazhdoi procesin e hartimit dhe miratimit të ligjeve.

Gjatë këtyre viteve roli i Kuvendit është rritur ndjeshëm në krijimin e një kuadri kushtetues e ligjor, si premisë për vendosjen e shtetit juridik. Ai është kthyer në institucionin më të rëndësishëm të zhvillimit të jetës politike në vend. Veprimtaria legjislativë është bërë një nga instrumentet më aktivë në konsolidimin e institucioneve të shtetit dhe të integritimit euroatlantik.

SKËNDERBEGAS PËRTEJ OQEANIT



VERI TALUSHLLARI

MIK MES SKËNDERBEGASVE: SANDËR PROSI

Mësuese Sashenka Rino trokiti dhe hapi lehtë derën e klasës, duke e befasuar pak komandantin e kompanisë që po na jepte mësim armatimi.

- Më fal komandant Petriti, mund të marr Verin? Na duhet ta dërgojmë diku, me urdhër të Komisarit të Shkollës.

Edhe vetë u befasova. Në korridor Sasha më hodhi dorën në sup dhe më pyeti në e kisha gati uniformën e liraljaljes. Sigurisht gati e kisha.

Ndërkohë mbërritëm në sallën e mësuesve, ku ishin dhe dy mësueset e tjera të Letërsisë, të mrekullueshmet Virginia Lafe dhe Flutura Xoxe.

Ajo që më thanë, pas befasisë, më habiti dhe më shumë. Do të më duhej të shkoja në Teatrin Kombëtar, do takoja Artistin e Popullit Sandër Prosi e do ta sillja në Shkollë për një bisedë me ne, skënderbegasit.

Takime të tilla nuk ishin të rralla, shkrimtarë, artistë, sportistë, veteranë të Luftës NÇL, etj., personalitete vinin në Shkollë për të folur për jetën dhe veprat e tyre, për ngjarje e data historike. Por shkrimtarët, këngëtarët, aktorët zakonisht vinin në tetor, në Muajin e Letërsisë dhe Arteve, e tani ishte fund-marsi a fillim-prilli, pranvera kish shpërthyer e plotë në Tiranë.

Mora autobusin për në Kombinat, zbrita te Banka dhe u drejtova për te Teatri. Ndjeja një si turbullirë në stomak, emocionet më kishin kapluar me gjithë fuqinë e tyre!

Sandër Prosi! Ai aktor i madh, me atë trup gjigand, me atë lojë aktoriale marramendëse, me atë zë!

E unë vërtet i ri, 19 vjeç djalë, me trup të imët, i shkathët, megjithatë, si do të dukesh para tij?!

Mendoja si do t'i përgjigjesha kur të më pyeste për këtë a për atë, ç' përshtypje do t'i bënin fjalët e mia. Rrugën nga Banka te Teatri pothuaj nuk e pashë, as njerëzit që shkëmbehesha, dhe ja, u gjeta te porta e madhe. Kisha vajtur para kohe dhe mendova se do të prisja, por u hap një derë dhe ja ku ishte Mjeshtri.

- O sa mirë, erdhe.

Hapi krahët dhe u gjenda me kokën në gjoksin e tij.

- Ikim apo rrimë pak te ai stoli?

- Ju e dini. Mirëdita.

- Ikim, ikim, nuk kemi ç' presim. Si e ke emrin?

- Veri...


- Veri? Nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë, ta gëzosh!

- Gjyshi ma ka vënë Veri, pasi kam lindur në korrik dhe kur i thanë, buzë lumit ku kemi shtëpinë frynte një fllad nga veriu.

Ai qeshi me të madhe me atë zërin si bubullimë dhe më përqafoi edhe njëherë. Mendova se mos thashë ndonjë budallallëk, gjithë ato ç' kisha menduar t'i thosha, avulluan. Tani, ndërsa ecnim vura re diçka: nuk e hiqte cigaren "Partizani" nga buzët. Dhe kishte një zakon të çuditshëm: e thyente cigaren në mes, e me atë që kish në buzë ndizte tjetrën. I numërova, nga Teatri te stacioni për në Kinostudio ndezi 7 gjysmë-cigare! Rrugës më pyeti për familjen, a më kish marrë malli për Përmetin, (ne banonim atje në atë kohë) për mësimet...e unë çuditërisht nuk e kisha më atë ngacmimin në stomak. Në autobusin urban dikush i liroi vendin dhe deri te stacioni i shkollave ushtarake nuk do të flisnim. Por aty i Madhi Sandër Prosi më la pa gojë. Ndërsa dola ta vija në të djathtë për respekt, ai doli në të majtën time dhe tha:

- Jo, ti e ke vendin këtu. E ka uniforma që ke veshur! Ç' ti thosha?! Hymë në postbllok, shokët e mi na përshëndesnin dhe disa edhe me grusht dhe para kinemasë na prisnin mësuesit tanë. Ai ecte ngadalë dhe shikonte majtas e djathtas. Gjithçka ishte e pastër, rrugët të fshira, bordurat të bardha, gjelbërim gjithandej, trungjet e pemëve të gëlqerosura...

- Si shkoi rruga? - më pyeti Sasha, e nën zë: - Po pse nuk e



vure në të djathtë? - Kur i thashë pse, mbeti dhe ajo gojë hapur dhe u tregoi dhe kolegeve. Mësuese Virxhinia i kërkoi falje pasi Shkolla kishte ditën e dushit dhe do të prisnim pak. Kështu filloi një bisedë që Sandri e bëri të paharrueshme. Ky takim ishte planifikuar një muaj më parë, por ndodhi një e papritur e madhe: vdiq Naim Frashëri, aktori, Artisti i Popullit. Pasi foli për dhimbjen që la pas, për madhësinë si aktor dhe si mik, sikur e dëgjoj edhe sot, pas gati 50

vjetësh, kumbimin e zërit të tij:

- Naimi ishte një shqiptar i madh!

Në ato çaste, një shoku im ynë, djalë i shkathët, Zihni Shkurti, që ashtu si ne kish filluar të botonte edhe ndonjë vjershë, kish mbledhur një tufë mimozash dhe ia dhuroi mikut. I mori me kënaqësi, falënderoi dhe ia dhuroi Fluturës.

Ndërkohë salla po mbushej dhe ne duhej të bëheshim gati të hynim. Por surprizat e atij njeriu të rrallë nuk kishin mbaruar. Më pëshpëriti në vesh se më parë donte të shkonte në tualet dhe unë i thashë: "Po, ejani me mua". Ai duke qeshur u tha mësuesve: "Ç'të bësh, pleqëri", megjithëse nuk ishte, veçse pak mbi të pesëdhjetat.

Nuk u mendova dy herë se te cila fjetore do ta çoja: te Bashkim Bregu! Skënderbegasi i shërbimit na hapi derën dhe u gjendëm në hapësirat mes krevateve. Sandri hodhi një vështrim rreth e rrotull dhe mbeti gojëhapur! Rregulli ishte i përsosur! Krevatet e rregulluar bukur, çarçafët ndrinin, vijëzimet e tyre, të jastëkëve, fundet e krevateve, peshqirët, shapkat...ç'do gjë në vendin e vet! Dielli që vinte nga dritaret binte mbi pllakat dhe gjithçka ndriçonte mahnitshëm. Kaluan 10 sekonda, 20, 30, një minutë, dhe miku ynë nuk po lëvizte!

Në një moment unë u kollita lehtë dhe ai sikur u zgjua nga ndonjë ëndërr. Na vështroi i menduar dhe përsëri me atë zërin e bukur, me gishtin tregues të ngritur, tha:

- Prandaj i thonë disiplinë ushtarake!

- Unë isha krenar që ne, skënderbegasit, kishim bërë që edhe një njeri me emrin dhe famën e Sandër Prosit, të na admironte. E tha dhe gjatë bisedës në kinema, se kish marrë një mësim të madh,

se ç'do të thoshte rregull e disiplinë. Kur unë i thashë se disiplina e skenës është shkalla më e lartë e disiplinës, ai qeshi dhe tha se kështu duhet të jetë, po sot unë pashë diçka që më mësoi shumë.

Bashkë me nëndrejtorin, Sotir Stavre, u ngjitëm në skenë dhe takimin e hapa unë. Mjeshtri tha se ishte tiranas, por kishte lindur aksidentalisht në Shkodër. Nëna ishte shkodrane dhe mbeti te vëllezërit, se nuk kishte transport atëherë.

Ishte viti 1920.

Tha se shkollën e kishte bërë për dentist dhe pastaj foli për jetën artistike. Nuk foli gjatë, se më tepër donte t'u përgjigjej pyetjeve tona. Sigurisht e pyetëm se ç'po filmonte dhe nuk e harroj përgjigjen e tij. Filmohej "Në fillim të verës".

- Kam rolin e xha Jahos. Është i bukur, por shumë rol i vështirë. Është si një trung i madh e që duhet gdhendur!

- Do ta gdhendësh! - bërtiti dikush dhe salla duartrokiti. Biseda ishte e këndshme dhe koha fluturoi. Nuk di nëse Sabriu dhe Kudreti, çunat e qendrës së zërit, e kanë regjistruar, dhe më vjen keq që nuk kam as ndonjë foto nga ajo ditë, pasi e kujtoj Nazmiun me blicin e tij.

Pasi u nda me mësuesit, mua më thanë ta shoqëroja deri te shtëpia dhe ne morëm rrugën e kthimit. Ai banonte diku pranë Librarisë "Flora", dhe megjithëse më ftoi në shtëpi, u ndamë dhe më përqafoi fort.

- Shkollë e bukur, më kënaqët sot. Nuk do ta harroj, do t'u them dhe shokëve. Dhe të fala nga shtëpia! Do takohemi prapë!

Dhe vërtet u takuam shpejt. Pas pak kohësh jepte shfaqje Trupa e Prishtinës, "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur", me regji të Piro Manit, po ishte e pamundur të gjeje biletë. Kështu unë ruajta kur po vinte miku ynë i madh dhe i dola para. I thashë se nuk mund të gjeja biletë dhe se isha me një shok.

- Ejani me mua! - tha, dhe kështu bashkë me Xheladin Çelmetën e pamë nga një llozhë, ku Sandër Prosi u ul me të Madhen tjetër, Margarita Xhepën. Ja, kjo ishte ajo ditë e paharruar pranvere, kur Shkolla jonë kishte një mik të vyer, një aktor të shquar, një njeri të mrekullueshëm, edhe ai një shqiptar i madh.




Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

IBRAHIM SELIMI, USHTARAKU, MËSUESI DHE ATDHETARI PATRIOT

Me rastin e 170-vjetorit të lindjes së ish-ushtarakut, mësuesit të mirënjohur të trevës së Krahësit “Nderi i Kombit” Ibrahim Selim Zyka (25.5.1853 – 13.11.1935), patriotit, prijësit e mik i kapedanëve, zemërzjarrtit që rindezi zemrat dhe prushin atdhetar nën frymën e Rilindjes Kombëtare kundër pushtimeve osmanë, grekë e italianë. Ibrahim Selimi ishte një prej kontribuuesve të spikatur në lëvizjen kombëtare në Krahës e Tepelenë, një ish-ushtarak bashkëpunëtor i komandantit të xhandarmërisë së Janinës Ismail Lesko Progonati, një pishtar i arsimimit në gjuhën shqipe si iniciatori i ngritjes së shkollave të para shqipe në Tepelenë më 1908, në Koshtan, si dhe çeljen e shkollave të tjera shqipe në Progonat, Matohasanaj, Labovë si vatrë e zjarrit të dritës së diturisë. Në vitin 1920 ishte pjesë e drejtimit dhe organizimit të Luftës së Vlorës për zonën e Tepelenës si dhe një frymëzues i luftës pa kompromis kundër italianëve. Për këtë figurë madhore ka realizuar një monografi të posaçme profesori Bardhosh Gaçe, me një monografi për “Rilindjen e mësuesit atdhetar Ibrahim Selimi”, por kanë shkruar edhe shumë të tjerë.)

Truall atdhetar me rrënjë të thella të shqiptarizmit

Nëpër rrënjët shekullore shqiptare spikasin figura madhore të vlerave, sikurse është Ibrahim Selimi i parë, ushtaraku i xhandarmërisë që në Vilajetin e Janinës e më tej edhe mësues atdhetar në jetën e tij, që në fakt është jeta e një rilindasi të fillim-shekullit të XX-të, e ka përmbledhur në një biografi sinjifikative prof. Bardhosh Gaçe. Ibrahim Selimi ishte dhe mbeti pjesë e Rilindjes Kombëtare, sepse shkriu jetën e tij për shqiptarizmin, për çlirimin kombëtar, për shkollën kombëtare, për Krahësin e Tepelenën. Ai ishte pjesë e ish-ushtarakëve që shërbyen denjësisht për mbrojtjen e shqiptarëve në vilajet nga dhuna e andartëve që kërkonin të kafshonin pjesë të truallit kombëtar arbëror. Ai ishte gjithashtu pjesë e armatës së lëvizjes kombëtare, për zgjimin kombëtar të shqiptarëve, për krijimin e shtetit dhe futjen e shoqërisë shqiptare në rrugën e zhvillimit dhe përparimit. Velikajt e Ibrahim Selimit në Krahësin e sipërm, rreth vitit 1724 kishin zbritur nga Nivica e Kurveleshit. Ata vijuan traditën e të parëve të mbarështimit të bagëtive edhe pse represioni i pushtimit osman nuk kishte të ndalur. Megjithatë mbijetesa ishte veti e shqiptarëve, për të mos u mposhtur përballë çdo vështirësie. Bujaria ishte traditë dhe e drejtë zakonore e përhershme e rrënjësor



Mësuesi atdhetar IBRAHIM SELIMI

thellë tek Selim Zyka dhe Zykë Velika kanë marrë pjesë si luftëtarë të shquar popullorë në luftërat dhe kryengritjet kundra pushtuesve osmanë të viteve 1828, 1834, 1847 dhe vitet që pasuan. Ata luftuan sup-bashkuar me kapedanët e tjerë të Labërisë Zenel Gjoleka, Tafil Buzi, Veiz Vasjari, Rapo Hekali, etj., për mbrojtjen e trojeve shqiptare edhe në Plavë e Guci në Mal të Zi. Ishte koha kur trokiste fuqishëm zgjimi i ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve.

Ibrahim Selimi - jetë në shërbim të kombit

Ibrahim Selim Velikaj erdhi në jetë, më 25 maj 1853, në një familje me rrënjë të thella atdhetarie, patriotike e luftarake. Pas pak ditësh ka 170-vjetorin e lindjes dhe mësuesi atdhetar Ibrahim Selimi i ngelur në kujtesën e brezave është sfondi më i bukur i historisë së trevës së Krahësit. Por historia, si

në çdo trevë shqiptare, përcillet me gojëdhënë dhe me këngë. Këngët u bënë trumbeta e lirisë shekujve, prandaj dhe Ibrahim Selimi i mësoi që në vogëli:

“Që në Krahës e Bolenë,/Gjithë me Balil u ngrënë,/Lidhën fjalën e bënë benë,/Që nizamë të mos venë”, ose “Ç’u ngrënë o shokë ç’u ngrënë,/Treqind niviciotë levendë.../Kërcyen në Tepelenë...”.

Shpejt u burrërua para kohe dhe në vitin 1871, në moshën 18-vjeçare, gjendet në Selanik, në fundin e gushit 1871 me 400 rekrutë që stërviteshin në karantinë për kalorësi, artileri bregdetare dhe vend-rojet e Mesdheut. Ibrahim Selimi mësoi me zell turqishten dhe persishten. Më 1877 gradohet oficer kavalerie dhe emërohet në taborin/batalionin e Selanikut. Kreu me sukses edhe një kurs njëvjeçar dhe u emërua në garnizonin ushtarak të

Janinës, ku zuri miqësi me intelektualë nga Labëria, Tepelena, Gjirokastra, Mirdita, Manastiri, Preveza, Tetova, Filati etj. Ndërkohë në gji i vlonte shpirti rebel anti-pushtues. Më 1904 emërohet në garnizonin e Meçovës, atje ku, më 1854, ishte zhvilluar një luftë e përgjakshme për mbrojtjen e tokave shqiptare, një betejë që pati 800 të rënë shumica nga Labëria, por dhe nga treva e tij e Krahësit.

Në Meçovë shkoi njëherazi me Iliaz Filatin. Nuk ishte thjesht rastësi, kur atdhetaria i bashkon njerëzit, sepse Ibrahim Selimi ishte zëvendës i komandantit të xhandarmërisë së Janinës, Ismail Lesko Progonati, që tregoi burrëri dhe trimëri të rrallë përballë bandave të andartëve grekë, që vrisnin e digjinin fshatrat shqiptarë e vlleh në Meçovë, Paramithi dhe gjithë Vagenetinë/Çamërinë, territor



NËPËR RRËNJËT SHEKULLORE SHQIPTARE SPIKASIN FIGURA MADHORE TË VLERAVE, SIKURSE ËSHTË IBRAHIM SELIMI I PARË, USHTARAKU I XHANDARMËRISË QË NË VILAJETIN E JANINËS E MË TEJ EDHE MËSUES ATDHETAR NË JETËN E TIJ, QË NË FAKT ËSHTË JETA E NJË RILINDASI TË FILLIM-SHEKULLIT TË XX-TË, E KA PËRMBLEDHUR NË NJË BIOGRAFI SINJIFIKATIVE PROF. BARDHOSH GAÇE. IBRAHIM SELIMI ISHTË DHE MBETI PJESË E RILINDJES KOMBËTARE, SEPSE SHKRIU JETËN E TIJ PËR SHQIPTARIZMËN, PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR, PËR SHKOLLËN KOMBËTARE, PËR KRAHËSIN E TEPELENËN.

ilir epiriot, “bërthamë e trojeve shqiptare”.


Emrat e kapiten Ismail Lesko Progonati, Ibrahim Selimi, Haki Bala, Ismail Leskoviku janë të njohur për kontributin e veçantë në Vilajetin e Janinës. Nga ana tjetër, rritja në një shkallë të lartë të ndërgjegjes kombëtare veç kryengritjeve kërkonte shkollë e arsimim. Prandaj Ibrahim Selimi u përfshi në kryengritjet anti-osmane 1908-1912, si dhe në çeljen e shkollave shqipe, ku rol parësor luajti në Krahës të Tepelenës, që u shndërrua në një personalitet i lëvizjes kombëtare dhe arsimit kombëtar shqiptar. Mësuesi Ibrahim Selimi në rinin e tij u ushqe me ndjenjat kombëtare, duke mësuar gjuhën shqipe të Sheh Ademit në Berat së bashku me kunatin e tij Dervish Medini dhe bashkëpatriotë të

◻ Ibrahim Selim Velikaj erdhi në jetë, më 25 maj 1853, në një familje me rrënjë të thella atdhetarie, patriotike e luftarake. Pas pak ditësh ka 170-vjetorin e lindjes dhe mësuesi atdhetar Ibrahim Selimi i ngelur në kujtesën e brezave është sfondi më i bukur i historisë së trevës së Krahësit. Por historia, si në çdo trevë shqiptare, përcillet me gojëdhënë dhe me këngë. Këngët u bënë trumbeta e lirisë shekujve, prandaj dhe Ibrahim Selimi i mësoi që në vogëli: “Që në Krahës e Bolenë,/Gjithë me Balil u ngrënë,/ Lidhën fjalën e bënë benë,/Që nizamë të mos venë”, ose “Ç’u ngrënë o shokë ç’u ngrënë,/Treqind niviciotë levendë.../ Kërçyen në Tepelenë...”.

tjerë. Në Janinë Ibrahim Selimi kishte gjetur shumë miq e shokë të lëvizjes kombëtare që në vitet 1904-1908 bashkëpunoi me atdhetarët Isuf Bushi, Halil Gjirokastra, Feim Mezhgorani, Shaqo Buzin, Shuko Dalipin etj. Sikurse shkruan atdhetari Aristidh Ruci, “Puna e çmuar për hapjen e librave shqip në Tepelenë kishte rënë në sy dhe të xhandarmërisë”.

Ibrahimi kishte fillimisht besim të lëvizja Xhonturke/turqit e rinj të 1908-s dhe shpallja e Kushtetutës për përfitimin e autonomisë e lirisë së popujve të robëruar. U bë pjesë e demonstratave në Janinë, në shpërndarjen e armëve në Çamëri e Himarë për nxitjen e kryengritjes shqiptare dhe mëvetësi. Në tetor 1908, Ibrahim Selimi me baba Ahmet Resulin e Qamil Rustemin, bazuar në rekomandimet e klubit shqiptar të Manastirit u përfshinë në çeljen e shkollave shqipe në Tepelenë. Siparin e hapi çelja e shkollës shqipe të Koshtanit, më tej shkollat në Matohasanaj, Progonat, Tepelenë e Labovë u bënë vatër e zjarrtë për dituri. Marrëdhënie të ngushta patën edhe me Petro Nini Luarasin, Çerçiz Topullin, Klubin “Bashkimi” në Janinë, Klubin “Drita” në Gjirokastër. Më 1911-1912, krahas shkollës së Krahësit, mësuesi Ibrahim Selimi ishte pjesë e intelektualëve e prijësve në Tepelenë, Kurvelesh, Mallakastër, që koordinonin e bashkëpunonin veprimet me patriot si: Riza Runa, Namik Delvina, Ismail Kaso, Kanan Maze, Selam Musa Salaria etj., që mbështetën fuqimisht morandiumin e Gërçes të shkruar nga Ismail Qemal Bej Vlora. Veprimtaria atdhetare e Ibrahim Selimit dallohej përkrah Ismail Qemalit dhe që në gusht 1912 ishte përkrah krerëve të tjerë kryengritës si përfaqësues i trevave të Jugut të vendit. Në shpalljen e pavarësisë Ibrahim Selimi mori pjesë në luftën kundër andartëve që dogjën e shkatërruan viset jugore të vendit dhe vranë mbi 3000 shqiptarë. Nga Tepelena, Ibrahim Selimi me baba Ahmet Turanin, Feim Mezhgoranin, Ismail Kason etj., i dërgojnë letër Ismail Qemal Beut për masakrat e

ushtarëve dhe andartëve grekë. Askush nuk i harroi kurrë fjalët që shkroi Ibrahim Selimi në dërrasën e zezë të shkollës në Krahës: “..Atdheu u bë i lirë dhe i mosvarur. Këtë çast janë ringjallur Skënderbeu dhe Naim Frashëri dhe gjithë martirët e kombit”. Në vitet 1919-1920, mësuesi Ibrahim Selimi në protestat dhe memorandumet e dërguar Konferencës së Paqes në Paris, e kishin zanafillën në takimet në Tepelenë me të dërguarin e Presidentit Wilson të SHBA-së, në Tepelenë, Gjirokastër e Përmet me konsullin Josuf Havan për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Ai u shndërrua në një udhëheqës shpirtëror të Krahësit e Tepelenës pasi ishte në krye të çdo debati dhe nisme për të drejtat e shqiptarëve, bashkë me patriotë të tjerë si baba Ahmet Turani, Riza Runa, Halim Xhelo, Kanan Maze. Ai është pjesëmarrës në Malin e Beunit pranë fshatit Vajzë të Ali Asllanit, ku u takua me miqtë e tij Osman Haxhiu dhe dymbëdhjetëshen që drejtonte luftën si Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare etj. Lufta e Vlorës është epike e madhe fitimtare e shqiptarëve e shqiptarëve, e 89 çetave ku rol të veçantë ka kontributi i çmuar i Ibrahim Selimit. Në vitin 1921-1924 Ibrahim Selimi mori pjesë gjallërisht në lëvizjen demokratike të kohës bashkë me Arshi Shehu, Halim Xhelon, Avni Rustemin, Veli Harshovën, që e donin Shqipërinë në modelin e qytetërimit perëndimor. Dorëshkrime të bashkëkohësve e vërtetojnë se Ibrahim Selimi me vetëdije të plotë u përfshi në lëvizjen demokratike të kohës, mori pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924, përkrah Fan Nolit. Qeveria e Nolit e caktoi officer në disa detyra në Lushnjë, Peqin e Laprakë. Në jetën ushtarake jo gjithçka shkonte qetë, sepse situatat komplekse që kalonte Shqipëria nuk mund të shpëtonin nga dhuna dhe incidentet. Kështu, në zonën e Laprakës Ibrahim Selimi shpëton për mrekulli nga një incident banal me armë me një kolegun e tij opozitar, që i kërkonte të ndihmonte Ahmet Zogun dhe jo Fan Nolin. Ndërkohë, u zhgënjye nga dobësitë e qeverisë dhe administratës



shtetërore, por dhe problemet sociale e shoqërore që nuk merrnin zgjidhje. Pas dështimit të qeverisë së Nolit, në dhjetor të vitit 1924, kthehet në fshat duke vazhduar detyrën patriotike të mësuesit, deri sa ndërroi jetë në vjeshtën e viti 1935. Fakt është se në takimet me Naum Priftin në Lushnjë, Qazim Koçulin e Spiro J. Kolekën në Tiranë lidheshin me mjerimin dhe varfërinë e fshatarëve dhe moszgjidhjen e halleve të tyre nga ana e qeverisë. Kjo e brengoste më shumë se gjithçka. Më datën 28.11.1924, Ibrahim Selimi mori pjesë në Kuvendin zakonor të Labërisë, në Kuç të Labërisë, si përfaqësues i Krahësit. Kjo, një ngjarje e rëndësishme në jetën Labërisë me ndikim të thellë në emancipimin e jetës dhe eliminimin e gjakmarrjes dhe zakoneve të egra. Ai ishte nismëtar dhe mori vetë pjesë në disa pajtime grindjesh, sherresh e gjaqesh në Lopës, Mallakastër e Kudhës, si përfaqësues i pleqësisë së Labërisë.

Ideale që nuk treten, pasi “amanetin nuk e tret dheu!”

Ibrahim Selimi ka qenë një atdhetar i vendosur për një Shqipëri të lirë. Ai ishte mësuesi i parë dhe iniciatori i ngritjes së shkollës së parë shqipe në Tepelenë në vitin 1908, ka qenë pjesë e të gjitha zhvillimeve shqiptare, ngjarje që kanë ngelur në memorie të kombit si Pavarësia, Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës, ngjarjet e luftës së 1920-tës, çuan në pavarësinë e dytë shqiptare, përjetoi Republikën e parë, qeverisjen Noliane dhe regjimin mbretëror. Por

në zemrën e tij ngeli i pashuar pishtari i atdhetarisë. Jeta e veprimtaria e Ibrahim Selimit, atdhetarit të flaktë të Krahësit, mësuesit patriot me gjurmë të thella në krahinë e tij, sepse nuk kurseu asgjë për idealin e çështjes kombëtare. Në këto kushte kur Shqipëria jetonte kompleksitetin e kohës Ibrahim Selimi u shua në vjeshtën e vitit 1935, por që la si amanet që: “koka e varrit të ishte në drejtim të shkollës shqipe të Koshtanit”, një amanet i plotësuar nga brezat. Amaneti i tij lidhej me varrosjen jashtë varrezave të fshatit, pak më lart, në një kodër dhe kokën t’ia kthenin jo si gjithë të tjerët, nga perëndimi sikurse ishte riti mysliman, por nga shkolla, pasi atje kishte lënë shpirtin, atje tek shkolla shqipe në drejtim të saj dhe për mençurimin e shkollimit e brezave, ky ishte mesazh që u përcillte brezave edhe kur të mos ishte në jetë. Ai është qiri i pashuar i gjuhës dhe shkollës shqipe, që nga ushtarak përqafoi profesionin e mësuesit. Ai është atje në amanetin e brezave, tek Bregu i Shahut mes lisave. Duket sikur akoma dëgjohet oshtima e fjalëve të atdhetarit Ibrahim Abdullai nga Vlora dhe bashkëfshatarit të tij Kalo Brahimi, që referuan jetën e mësuesit dhe atdhetarit të paharruar Ibrahim Selimi. Gojëdhëna e transmetuar brezave flet gjithashtu se atdhetari Ibrahim Selimi është mbajtur dy ditë pa varrosur deri sa erdhi nga Vlora miku i tij dhe familjes së tij, patrioti Ibrahim Abdullai nga Vlora, si dhe është mbajtur dy vjet zi. Edhe pse mbi supet

e mësuesit atdhetar Ibrahim Selimi, pas vdekjes në vitin 1935, mjegullat e kohës pllakosën me një heshtje të rëndë, nuk zgjati shumë, sepse monografi dhe shkrime të shumtë e rizgjuan dhe fshinë pluhurin e harresës. Por populli ka një maksimum proverbiale të pagabueshme “E drejta zhytet por nuk mbytet”. E drejta triumfon përherë. Përveç profesor Bardhosh Gaçes, në rinxjerrjen në dritë të figurës së tij kanë dhënë kontribut Fatmira Rama, Bernard Zotaj, Pelivan Hysi, Albert Zholi, Veli Llakaj, Ibrahim Velika, e shumë të tjerë. Koha ecën, ideali pishtar nuk harrohet. Nuk shuhet zëri i dritës së ditorisë, edhe sot pas 170 viteve nga lindja e tij, sepse figura e ushtarakut, mësuesit, luftëtarit e atdhetarit Ibrahim Selimi, nuk u mbulua nga pluhuri i harresës. Personaliteti i tij shkëlqen për shërbimin e denjë për Atdheun e kombin. Prandaj edhe është vlerësuar me dhjetëra nderime, dekorata e urdhra, por shkëlqen mbi të gjitha dekorata e lartë që iu akordua më 20.8.2020, nga Presidenti i Shqipërisë, i cili i akordoi Ibrahim Selimit dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” (pas vdekjes), me nr. Dekreti 11613, datë dekreti: 13.8.2020 me motivacion: “Për kontributin e tij të njohur për Pavarësinë, arsimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. I shquar për aftësitë drejtuese dhe trimërinë në Luftën e Vlorës (1920), ai ishte një prej komandantëve më të shquar të Komisionit të Mbrojtjes Kombëtare për Tepelenën”.

MINISTRI PELESHI:

Pagat e ushtarakëve ishin për një kohë të gjatë një arsye për t'u ndjerë keq për trupat e Forcave të Armatosura, por s'kishim asnjë rrugë tjetër përveçse të çonim përpara me këmbëngulje e durim ndryshimet e domosdoshme, pa të cilat pagat nuk mund të rriteshin siç duhej dhe siç e dëshironim të gjithë. Tanimë kushtet kanë ndryshuar shumë dhe ushtarakët tanë nuk janë më të fundit e rajonit për nivelin e pagave të tyre, ata kanë paga ndër më të lartat, të cilat do të vazhdojmë t'i rrisim drejt mesatares së NATO-s. Rritja me 37% do të pasohet me një tjetër rritje në vitin 2024.

